



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / Ministarstvo Trgovine i Industrije /
Ministry of Trade and Industry
Departamenti i Tregtisë / Departament Trgovine / Department of Trade

Barrierat tregtare: Lehtësimi i tregtisë si mjet për eliminimin e tyre

Anita Sutaj, Bulinë Gashi, Merita Fetahu, Zef Dedaj
Prill, 2018

Abstrakt

Liberalizimi i tregut ishte parë mjaft i suksesshëm kryesisht nëpërmjet reduktimit të tarifave dhe ndikimi më i madh ishte arritur me tregtinë multilaterale të mundësuar nga Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT) të miratuar në vitin 1947. Kjo marrëveshje me pas ishte zëvendësuar me Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) e cila shërben si parim bazë për çdo marrëveshje tregtare. Ndonëse Kosova është pjesë e CEFTA-së, Marrëveshjes për Tregti të Lirë që nga viti 2006 si dhe e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit që nga viti 2016, të dyja të bazuara në parimet dhe rregullat e OBT-së, Kosova ende vazhdon të përballlet me një bilanc tregtar negativ, madje shumë të lart respektivisht në tregtinë e mallrave. Në këtë aspekt, njëra nga arsytet që ka penguar rritjen e eksportit në vazhdimësi është edhe numri i shpeshtë i barrierave jo-tarifore, të pa arsyeshme të aplikuara ndaj kompanive kosovare. Të gjeturat na tregojnë se Serbia karakterizohet më së shumti pothuajse në të gjithë sektorët dhe në të gjitha kategoritë, për vendosje të barrierave tregtare në drejtim të kompanive kosovare, e ndjekur më pas nga Shqipëria. Megjithatë, këto dy shtete mbeten edhe partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Kosovës. MTI ka themeluar komitetin nacional për lehtësira tregtare, i cili ka rrjedh si kërkesë nga CEFTA dhe do të ketë një rol kyç në zbatimin e protokollit shtesë i cili nëse do të zbatohet me sukses nga të gjitha vendet e CEFTA-së atëherë rezultati kyç i tij pritet të jetë zvogëlimi apo eliminimi tërësisht i barrierave jo-tarifore ndërmjet vendeve. Megjithatë, rezultatet mbetet të shihen, kjo për faktin se disa barrierat tregtare mund të kenë përmbajtje politike sidomos me disa vende të CEFTA-së dhe se ende nuk dihet nëse zbatimi i këtij protokollit do të arrij të eliminojë të gjitha barrierat në tersi dhe të sjell rezultatet e pritura.

Hyrje

Kosova ende vazhdon të ballafaqohet me një deficit të jashtëm tregtar mjaft negativ, veçanërisht në tregtinë e mallrave. Fakti që Kosova ka nivelin më të ulët të eksporteve në rajon është një shenjë e qartë e vështirësive me të cilat përballen

kompanitë kosovare në tregtinë ndërkombëtare, respektivisht nga vendet anëtare të CEFTA-së, ku shumë nga këto vështirësi kanë të bëjnë me barrierat tregtare. Në këtë drejtim, barrierat në tregti përdoren nga vendet e CEFTA-së në

drejtim të Kosovës. Prandaj, qëllimi i kësaj analize është që në mënyrë sa më specifike të ofroj një pasqyrë të përgjithshme të llojit dhe natyrës së problemeve tregtare me të cilat kompanitë kosovare hasin gjatë eksportit dhe importit të tyre. Analiza gjithashtu hedh dritë mbi mjetet në dispozicion për të adresuar dhe eliminuar jo vetëm barrierat tregtare në nivel rajonal dhe më gjerë por edhe ato në nivel vendor që eventalisht mund të paraqiten. Materiali i përdorur në këtë analizë është i bazuar në rastet konkrete të barrierave të ndryshme qofshin ato tregtare apo të ndonjë natyre tjetër që janë sjellë në vëmendjen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nga vet sektori privat, qoftë ato të adresuara përmes mekanizmit për politika tregtare apo edhe takimeve individuale me biznese. Prandaj synojmë që përmes kësaj analize të paraqesim se me çfarë lloj të barrierave përballen kompanitë dhe një pasqyrë të përgjithshme të mjedisit të tyre aktual operativ. Në tregjet e jashtme, shumica e problemeve kanë të bëjnë me barrierat teknike të tregtisë. Në këtë rast, Serbia karakterizohet më së shumti në gati të gjithë sektorët dhe pothuajse në të gjitha kategoritë e barrierave. Megjithatë, Serbia është një nga partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Kosovës, pasuar nga Shqipëria dhe Maqedonia. Ndërsa sa i përket tregut të brendshëm të Kosovës, llojet më të dukshme të pengesave janë kushtet e konkurrencës dhe çështjet që lidhen me tatimet. Në këtë analizë, barrierat e ndryshme të cilat përballen kompanitë janë

Historiku mbi rendësin e liberalizimit të tregut dhe shfaqjen e barrierave jo-tarifore

Liberalizimi i regjimit të tregtisë ndërkombëtare ishte shumë i suksesshëm kryesisht nëpërmjet reduktimit të tarifave. Ndikimi më i madh ishte arritur me tregtinë multilaterale të mundësuar nga

të ndara sipas sektorit, llojit të pengesës, vendit apo institucionit. Të gjitha këto janë diskutuar nga pikëpamja e tregut të jashtëm dhe të brendshëm. Struktura e kësaj analize do të jetë si në vijim: pjesa e parë e kësaj analize në përgjithësi do të ofroj një pasqyrë të shkurtër mbi historikun e rëndësisë së liberalizimit të tregut duke filluar nga marrëveshja e GATT-it. Pastaj shkurtimisht do të përshkruhet metodologjia dhe metodat e ndjekura gjatë kësaj analize, si dhe do të vazhdohet me pjesën e shkëmbimeve tregtare duke përfshirë këtu partnerët tregtar kyç, duke i theksuar edhe produktet më kryesore të importuara dhe eksportuara. Ndërsa, pjesa e dytë e kësaj analize është e fokusuar në trajtimin e rasteve specifike dhe natyrës së barrierave tregtare të paraqitura mes vendeve të CEFTA-së konkretisht ato në drejtim të kompanive kosovare, gjithashtu edhe disa barrierat të paraqitura në tregun e brendshëm. Për më tepër, do të ofrojmë një pasqyrë edhe mbi zhvillimet e fundit sa i përket fushës së lehtësimit të tregtisë që konsiderohet si instrument për adresimin dhe eliminimin e barrierave ndaj tregtisë. Kurse pjesa e fundit do të ofroj konkluzionet. Dhe krejt në fund vlen të përmendët se përmbajtja e analizës është bazuar në informacionet e siguruara nga kompanitë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i cili është autoritet publik në Kosovë përgjegjës për adresim të barrierave në tregti.

Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT) të miratuar në vitin 1947. Ky instrument ndërkombëtar ka arritur në liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare dhe rregullimin e masave

specifike që i referohen si jo tradicionale tarifore, të cilat përfshijnë kuotat, masat anti-dumping, masat kundër-balancuese etj. Nga njëra anë, reduktimet e përhapura tarifore janë një arsye pse forma të ndryshme të masave jo-tarifore tani kanë tërhequr më shumë vëmendjen e negociatorëve. Një tjetër është se, shtetet kanë vendosur rregulla të reja. Vendet preferojnë masat që nuk rregullohen në nivel global. Organizata Botërore e Tregtisë ka prezantuar Barrierat Teknike në Tregti (TBT), marrëveshja e vitit 1995, por shumë masa apo barriera teknike tregtare tani mbeten të mundimshme për tregtinë, madje edhe në përputhje të plotë me marrëveshjen pasi jo të gjitha aspektet janë rregulluar plotësisht. Në të njëjtin vit marrëveshja për zbatimin e masave sanitare dhe fito sanitare (SPS) hyri në fuqi, por ajo ende lejon vendet për të vendosur kërkesat e tyre, nëse ato janë të bazuara në dëshmi shkencore. Parimisht, barrierat jo-tarifore i referohen masave dhe politikave të ndryshme nga tarifrat e zakonshme doganore, të cilat potencialisht mund të kenë efekt ekonomik në tregtinë ndërkombëtare të mallrave, duke ndryshuar sasinë e tregtuara ose çmimet, ose të dyja (UNCTAD, 2013). Gjithashtu, sipas Deardorf dhe Stern (1997), barrierat jo-tarifore përbëjnë të gjitha masat përveç tarifave që kufizojnë ose ndryshe shtrembërojnë fluksin e tregtisë mes vendeve. Ndërsa, sipas Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), barrierat jo-tarifore përbëjnë një grup jashtëzakonisht të ndryshëm të masave apo politikave të cilat mund të jenë

Metodologjia

Përzgjedhja e metodologjisë për të trajtuar çështjet të lidhura me barrierat tregtare me të cilat sektori privat në Kosovë ballafaqohet është e një rëndësie mjaftë

individualisht të ndryshme nga njëri-tjetri, pasi ato janë kolektivisht të ndryshme nga tarifrat e importit. Në këtë aspekt, si e vetmja arritje e raundit të tregtisë 'Bali', Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë (TFA) ka dalë në vitin 2014 për të trajtuar pengesat administrative për tregtinë dhe çështjet e transparencës. Në muajin Shkurt 2017 është aprovuar TFA nga Këshilli i Përgjithshëm i OBT-së dhe zbatimi i tij është aktualisht në proces. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë hyrë në liberalizimin e tregtisë rajonale me Marrëveshjen për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore në vitin 2006, liberalizimin e tregtisë në produktet industriale. Më vonë, liberalizimi i produkteve bujqësore është arritur dhe negociatat mbi tregtinë në shërbime tashmë kanë përfunduar në Dhjetor të vitit 2016. Ka disa nisma rajonale, të tilla si lehtësimi i tregtisë në rajon me negocimin e Protokollit 5, lëvizja e punëtorëve dhe fuqisë punëtore të kualifikuar, të cilat janë konsideruar për të ardhmen. Por ka ende raste, madje edhe të izoluara ndonjëherë, kur komuniteti i biznesit nga palët e CEFTA-së hasin barriera të drejtpërdrejta apo të tërthorta në tregti. Edhe pse ekzistojnë marrëveshjet, vlen të theksohet se njohja reciproke e certifikatave dhe raportet e testimi mungojnë në rajon. Marrëveshjet për njohjen reciproke nuk janë zbatuar për shkak të disa arsyeve formale, pasi që vendet nënshkruese nuk e shkëmbejnë listën e laboratorëve, por probleme të tjera janë më reale, për shembull, duke pasur ndryshimet në kërkesat e testimi.

interesante. Duke marrë parasysh rolin e MTI-së që ka në zgjidhjen e kërkesave të bizneseve brenda kompetencave të saj, MTI gjithashtu ka rol kyç edhe në adresimin e

barrierave tjera qoftë në nivel nacional si dhe ato në kontekst të marrëveshjeve tregtare, kjo për faktin pasi që MTI shërben si pikë kontaktuese në nivel të CEFTA-së dhe me gjerë. Në këtë drejtim, me qëllim rritjes së bashkëpunimit me sektorin privat MTI ka themeluar mekanizmat relevant me fokus të pranimit, adresimit dhe eliminimit të shqetësimeve që adresohen nga sektori privat. Prandaj metodologjia e përpilimit të kësaj analize është e bazuar sipas burimeve në vijim:

- Komiteti Nacional për Lehtësimin Tregtisë, i cili ka si synim përmirësimin e mëtutjeshëm të ambientit biznesor në Kosovë, gjegjësisht përmirësimin e mëtutjeshëm të procedurave dhe rregullave për import dhe eksport, me çka do të mundësoj lehtësimin e tregtisë në mes të Kosovës dhe vendeve tjera, me theks të veçantë vendeve fqinje;
- Departamenti i Tregtisë në MTI në kuadër të strukturës për Politika Tregtare organizon takime në baza të rregullta me bizneset nga sektori i bujqësisë dhe industrisë apo nën-sektor në kuadër të këtyre dy sektorëve;
- Përveç mekanizmit në fuqi, Departamenti i Tregtisë mban takime individuale me biznese varësisht nga kërkesat e tyre që mund të jenë sipas nevojës;
- Departamenti i Tregtisë ka një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me

Doganën e Kosovës, Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Amerikane, Oden Ekonomike Gjermane në Kosove, Klubin e Prodhuesve të Kosovës dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës;

- Gjithashtu, baza e të dhënave në nivel të CEFTA-së e cila mirëmbahet nga secili shtet me qëllim të vendosjes dhe raportimit të rasteve. Në këtë rast, Kosova raporton përmes kësaj baze të të dhënave rastet e aplikuara nga vendet e CEFTA-së ndaj kompanive kosovare, me ç'rast vendi aplikues i masës obligohet të jap një përgjigje zyrtare lidhur me vendosjen e masës, dhe në këtë formë janë bërë përpjekje për adresim dhe eliminim të rasteve. Duke marrë parasysh numrin e shpeshtë të barrierave tregtare të aplikuara ndaj kompanive kosovare, pothuajse barriera të pa arsyeshme, nuk mund të themi se kjo bazë e të dhënave ka qenë plotësisht e suksesshme në eliminim të plotë të barrierave tregtare të pa arsyeshme. Megjithatë, ky mekanizëm të paktën ka shërbyer si bazë për mbajtjen e statistikave në kuptimin e numrit, klasifikimit llojit dhe produktit me të cilat barriera janë ballafaquar të gjitha vendet e CFETA-së. Prandaj edhe në analizën tonë ka luajtur një rolë mjaft të rëndësishëm.

Tregjet më të rëndësishme të eksportit dhe importit të Kosovës në vitin 2017


Eksportet u rritën gjatë vitit në fjalë, vlera e tij ishte 22% më e lartë krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 378 milionë euro. Vendi kryesor i eksporteve ishte Shqipëria me një pjesëmarrje prej 16%, duke u rritur me më shumë se 40%. India ishte burimi i dytë më i madh i eksporteve me një

pjesëmarrje prej 14%, pasuar nga Serbia me një përqindje prej 13%. Ndërsa, në anën tjetër eksportet nga Maqedonia u rritën me rreth 19% në krahasim me vitin e kaluar. Vendet e tjera kryesore të importit ishin Zvicra, Gjermania, Mali i Zi dhe Holanda; importet nga Mbretëria e Bashkuar u rritën

deri në 13 herë, ndërkohë që pjesa e eksporteve totale të Kosovës u rrit në 3%. Vlen të theksohet se vendet kryesuese në

eksport përfaqësojnë 80% të eksportit të përgjithshëm në 2017.

Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës 2017, eksportet			
Shteti	Vlera e Eksportit	Pjesëmarrja %	Ndryshimi % 2017/2016
Albania	60,256,534.88	16%	43%
India	52,606,481.05	14%	458%
Serbia	48,245,969.97	13%	17%
Macedonia	45,850,258.96	12%	19%
Switzerland	21,354,826.12	6%	27%
Germany	20,193,790.29	5%	46%
Montenegro	19,875,953.56	5%	43%
Netherlands	12,760,483.80	3%	7%
Uunited Kingdom	11,192,184.21	3%	1337%
Austria	10,547,755.87	3%	57%



Burimi: ASK

Sa i përket eksportit, kthime dhe mbetjet ferrike dhe ferro-lidhjet përbëjnë kategorinë më të eksportuar të Kosovës në vitin 2017. Artikujt prej hekuri ose çeliku janë grupi më i madh i eksportit në vitin 2017 i cili është rritur me 30%. Në industrinë e plastikës dhe artikujt e saj, artikujt për transportimin ose paketimin e mallrave janë grupi më i madh i produkteve të eksportuara në 2017 me 8.6 milion në vitin 2017 ose 19% rritje nga 2016. Eksportet e xehet e plumbit në vitin 2017 arrijnë në 17.9 milion në 2017 ose 9% rritje nga 2016. Ndërsa, eksportet e xeheroreve dhe koncentrateve të zinkut në vitin 2017 arrijnë në 14.2 milion në 2017 ose 86% rritje nga 2016. Po ashtu, eksporti i


mobileve dhe pjesëve të tyre vazhdoi të rritet në vitin 2017. Si rezultat i trendit pozitiv eksportet në vitin 2017 tejkaluan shifrën korresponduese të vitit 2016 me 29%. Ndërsa sa i përket importet, ato u rritën gjatë vitit në shqyrtim, vlera e tyre megjithatë ishte 9% më shumë krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 3.04 miliardë euro. Vendi kryesor në import ishte Serbia me një pjesëmarrje prej 14.8%, duke u rritur me më shumë se 15%. Gjermania ishte burimi i dytë më i madh i importeve me një pjesëmarrje prej 12.4%, pasuar nga Turqia me një pjesëmarrje prej 9.6%. Ndërsa, importi nga Kina u rrit me rreth 7 për qind rritje nga 2016. Vende të tjera kryesore importuese ishin Italia,

Maqedonia, Shqipëria dhe Greqia; importet nga Shqipëria u rritën deri në 31% dhe pjesa e saj në importet totale të Kosovës u rrit në 5%. Megjithatë, siç mund të vërehet edhe

nga tabela, importet nga Kroacia dhe Italia u ulën ndjeshëm. Në këtë rast, vendet kryesuese në import përfaqësojnë 78.1% të importit të përgjithshëm në vitin 2017.

Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës 2017, Importet

Shteti	Vlera e Importit	Pjesëmarrja %	Ndryshimi % 2017/2016
Serbia	449,918,205	14.8%	16%
Germany	378,480,438	12.4%	10%
Turkey	292,701,461	9.6%	1%
China	275,516,652	9.0%	7%
Italy	194,716,162	6.4%	-4%
Macedonia	156,495,222	5.1%	0%
Albania	151,814,948	5.0%	31%
Greece	135,463,008	4.4%	14%
Bosnia and Herzegovina	81,673,648	2.7%	3%
Poland	80,147,029	2.6%	6%
Slovenia	63,889,190	2.1%	5%
Bulgaria	60,574,435	2.0%	6%
Croatia	58,326,335	1.9%	-1%



Burimi: ASK

Importi i produkteve të vajrave të naftës u rrit me 24% në vitin 2017 krahasuar me 2016. Automjetet motorike dhe automjetet e tjera janë një nga grupet më të mëdha të importit në vitin 2017, të cilat u rritën me 32%. Në industrinë e hekurit dhe çelikut, shkopinjtë dhe shufrat e hekurit janë grupi më

i madh i produkteve të importuara në vitin 2017 me 88 milionë në 2017 ose 21% rritje nga 2016. Importi i duhanit vazhdoi të rritet nga janari deri në dhjetor. Si rezultat i trendëve pozitive importet në 2017 tejkaluan shifrën korresponduake të vitit 2016 me 7%.


Barrierat tregtare dhe llojet e tyre

Sa i përket raporteve tregtare të jashtme deri më tani problemet më të zakonshme me të

cilat hasin kompanitë në tregtinë e jashtme janë të lidhura me procedurat doganore dhe

barrierat teknike të tregtisë. Problemet në lëvizjen ndërkufitare të mallrave kanë të bëjnë me procedurat aktuale doganore. Jo vetëm pagesat e ndryshme, por edhe ndryshueshmëria e tyre dhe parashikueshmëria e dobët e komplikojnë tregtinë. Barrierat teknike të tregtisë përfshijnë, për shembull, rregulloret e ndryshme teknike, standardet dhe certifikimet, të cilat janë diskriminuese ose të panevojshme. Procedurat doganore dhe

barrierat teknike ndaj tregtisë përbëjnë më shumë se gjysmën e të gjitha pengesave të identifikuara për tregtinë. Kategoria e ardhshme më e madhe e pengesave është mjedisi i biznesit në vendin e veprimit dhe licencimi. Në këtë drejtim, bazuar në informatat dhe kërkesat e pranuar nga sektori privat në Kosovë, më poshtë janë të identifikuara barrierat tregtare sipas natyrës së tyre.



Burimi: Departamenti i Tregtisë

Procedurat doganore për eksportin dhe importin e mallrave

Procedurat doganore i referohen të gjitha fazave që lidhen me lëvizjen ndërkufitare të mallrave në tregtinë e eksportit dhe importit. Çështjet që lidhen ngushtë me procedurën përfshijnë kodin e sjelljes, kategoritë e doganave, dokumentacionin e kërkuar dhe masat e tjera të veçanta. Nga të gjitha barrierat teknike të identifikuara në tregti, 38% janë të lidhura me procedurat

doganore. Më shumë se gjysma e të gjitha problemeve të identifikuara në lidhje me procedurat doganore hasen në eksportin dhe importin nga Serbia dhe Shqipëria. Vështirësi të konsiderueshme janë shkaktuar nga kërkesat e rënda të dokumentacionit, burokracia e rëndë dhe zhdoganimi i ngadaltë.

Lehtësimi i tregtisë, që është thjeshtëzimi dhe harmonizimi i procedurave të tregtisë ndërkombëtare, ka qenë në agjendën e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Qëllimi është të rrisë kapacitetin për asistencë teknike dhe mbështetje dhe të krijojë standarde që do të mundësonin një bashkëpunim efektiv midis autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera relevante publike. CEFTA AP5 - Qëllimi është të transformojmë Rajonin në të cilat mallrat, shërbimet, investimet dhe njerëzit e aftë lëvizin lirisht pa tarifa, kuota apo pengesa të tjera të panevojshme, ku tregtia lehtësohet më shumë se Rregullat e OBT-së, duke synuar njohja e të gjitha dokumenteve kufitare, sipas rastit (siç është specifikuar në Protokollin Shtesë 5).

Barrierat teknike ndaj tregtisë

Barrierat teknike të tregtisë i referohen ndryshimeve ndërmjet rregulloreve teknike, standardeve dhe vlerësimeve të konformitetit, të cilat pengojnë tregtinë. Shembuj të TBT tipike përfshijnë specifikime të ndryshme të produktit, certifikata të detyrueshme dhe dokumente, siç janë certifikatat e higjienës, certifikatat e konformitetit dhe certifikatat e pajtueshmërisë. Janë vendosur rregulla teknike për të siguruar që produktet janë të sigurta, janë bërë për një përdorim të caktuar dhe janë në përputhje me produktet e tjera, por në disa raste rregulloret gjithashtu mund të mbrojnë në mënyrë

efektive prodhimin dhe tregjet vendase. Bazuar në informacionin e mbledhur nga kompanitë, barrierat teknike të tregtisë janë pothuajse aq të zakonshme sa barrierat doganore dhe përbëjnë rreth 28% të të gjitha barrierave tregtare. Shumica e TBT-ve, mbi gjysma e tyre, janë hasur në Serbi; megjithatë, ato janë bërë një faktor që pengon tregtinë. Në Shqipëri dhe Serbi, problemet ndodhin sidomos në lidhje me kërkesat e certifikimit. Lista e produkteve të tilla luhet dhe prandaj, në situata të paqarta, nevoja për një certifikatë duhet të qartësohet paraprakisht.

Parimet bazë të Marrëveshjes së OBT-së mbi Barrierat Teknike në Tregti dhe Marrëveshja për Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fito sanitare përfshijnë mos diskriminimin, përdorimin e mjeteve më pak të tregtisë kufizuese dhe standardeve ndërkombëtare, si dhe transparencën e procedurave. Sipas këtyre parimeve bazë, të gjitha dispozitat përkatëse duhet të hartohen në mënyrë që të mos diskriminojnë një produkt në bazë të origjinës, efekti i tyre kufizues tregtar është i minimizuar dhe ato bazohen kryesisht në standardet ndërkombëtare. Për më tepër, transparenca duhet të sigurohet duke publikuar të gjitha dispozitat në kohën e duhur para se të hyjnë në fuqi dhe duke dhënë njoftime të veçanta në mënyrë të përshtatshme në rastet kur kërkohet njoftimi i tillë.

Ambienti i biznesit në vendet e operimit

Nga të gjitha pengesat e raportuara tregtare, rreth 9% lidhen me mjedisin e biznesit në vendin e punës. Kjo kategori përfshin, ndër të tjera, probleme të tilla shpesh sistematike si korrupsioni dhe burokracia dhe

problemet që rrjedhin nga mangësitë në infrastrukturë dhe pasiguria politike dhe ekonomike. Ambienti i biznesit është në fakt një element që luan një rol në të gjithë sektorët.

Lëvizja e personave

Rreth 3% e barrierave tregtare, që merren me tregjet e jashtme, kanë të bëjnë me lëvizjen e personave dhe elementet e lidhura me të, që kufizojnë tregtinë. Pengesa të raportuara lidhen me lëvizjen e personave midis Kosovës dhe vendeve të BE-së. Në pothuajse të gjitha rastet, të

anketuarit raportuan për proceset shumë të ngadalta, të komplikuara dhe burokratike të vizave të punës. Problemet në lidhje me vizat dhe lejet e punës nuk varen nga fusha e biznesit dhe ato ndodhin në të gjithë sektorët.

Kufizimet sasiore dhe licencimi

Kufizime të ndryshme sasiore, të tilla si kuotat e eksportit dhe të importit, së bashku me detyrimet doganore dhe taksat, gjithashtu kufizojnë tregtinë ndërkombëtare. Kërkesat e dokumenteve të licencimit dhe të kontrollit i përkasin kësaj kategorie; barrierat e identifikuar në këtë kategori përbëjnë rreth 13% të barrierave të raportuara në tregti. Një pjesë më shumë se mesatarja e barrierave është ndeshur në

Serbi dhe Shqipëri, por probleme të ngjashme janë hasur edhe në Maqedoni. Serbia kërkon licenca që ngadalësojnë tregtinë dhe shkaktojnë shpenzime shtesë. Nuk ekziston një fushë e vetme e biznesit që ndesh më shumë pengesa për tregtinë se një tjetër, por pengesat ndeshen relativisht në mënyrë të barabartë në të gjitha kategoritë e ndryshme.

Në parim, sistemi i OBT-së ndalon kufizimet sasiore. Megjithatë, kufizimet lejohen në raste të jashtëzakonshme, për shembull për të plotësuar instrumentet e politikës tregtare të përdorura në pajtim me rregullat e OBT-së. Licencimi mund të përdoret gjithashtu për qëllime të tilla si mbikëqyrja e pajtueshmërisë me rregulloret teknike. Masat duhet të zbatohen më pas në një mënyrë që kufizon dhe diskriminon tregtinë sa më pak të jetë e mundur me një ndikim të barabartë. Nenet XI dhe XIII të Marrëveshjes GATT dhe OBT Marrëveshja për Licencimin e Importit rregullon dispozitat për kufizimet sasiore dhe licencimin e importit.

Prokurimi publik i referohet prokurimit nga autoritetet qeveritare dhe nga administratat rajonale dhe lokale, siç janë shtetet federale, provincat dhe komunat, si dhe nga njësitë e prokurimit të fushave të veçanta. Rreth 3% e barrierave tregtare të hasura në

tregjet e jashtme janë të lidhura me prokurimin publik. Kompanitë kosovare hasin probleme në Serbi. Më shpesh, kërkesat, të cilat rezultojnë me përjashtimin e kompanive të huaja, shtohen në tenderim konkurrues.

Detyrimet antidumping, detyrimet kundër balancuese dhe masat mbrojtëse për eksportin dhe importin e mallrave

Detyrimet antidumping, detyrimet kundër balancuese dhe masat mbrojtëse janë politika tregtare, instrumentet e përdorura kundër masave të shtrembërimit të tregtisë që zbatohen përkohësisht për të rritur

detyrimet e importit për produkte të caktuara. Prej të gjitha barrierave të identifikuar tregtare, 6% janë të lidhura me këto instrumente.

Përdorimi i detyrimeve anti-dumping, detyrimet kundër balancuese dhe masat mbrojtëse i nënshtrohen Rregullave të OBT-së. Në Kosovë, tarifatat antidumping përdoren në situatat kur importimi nga vendet bazohen në dumping dhe aty ku ka pasur një efekt të kundërt në industrinë. Masat kundër balancuese mund të vendosen kur përfitimet nga importit kanë përparësi konkurruese në përpjesëtim me mbështetjen e qeverisë dhe kjo shkakton dëme tek prodhuesit në Kosovë. Masat mbrojtëse mund të merren për të mbrojtur industrinë në Kosovë kundër importit të papritur. Masat nuk duhet të jenë më gjithëpërfshirëse se sa është e nevojshme për të eliminuar përparësi konkurruese të fituar artificialisht.

Barrierat në Tregti sipas Sektorit


Duke u bazuar në raportet e industrive ushqimore ndaj pengesave tregtare dhe në numrin e barrierave të identifikuara tregtare, të gjitha pengesat tregtare ndeshen më shumë në industrinë ushqimore. Në këtë studim, produktet bujqësore përfshihen në industrinë ushqimore. Grupet më të mëdha të barrierave tregtare shihet të jenë procedurat doganore dhe barrierat teknike të tregtisë. Ata janë më të zakonshmet në Serbi dhe Shqipëri. Nga sektorët e ndryshëm, makinat dhe pajisjet së bashku me sektorin e TIK janë linjat e biznesit që

raportojnë për barrierat për të tregtuar më së shumti. Makinat dhe pajisjet si sektor përballen me shumë lloje të barrierave, por procedurat doganore dhe problemet në legjislacionin fiskal dallojnë pak në raport me sektorët e tjerë, pasuar nga barrierat teknike të tregtisë. Ndërsa në industritë tjera pengesat e raportuara në lidhje me linjat e industrive që nuk bien në asnjë nga sektorët e përmendur më lart. Ato përfshijnë, ndër të tjera, transportin, pijet, shtesat ushqimore. Shumica e problemeve rrjedhin nga procedura të rënda doganore.

Barrierat tregtare sipas vendit

Shqyrtimi i sektorëve të ndryshëm dhe llojeve të barrierave të mësipërme tregon qartë se shumica e të gjitha pengesave tregtare që hasin kompanitë kosovare në tregjet e jashtme ndodhin në tregtinë midis

Kosovës dhe Serbisë. Ky kapitull trajton barrierat tregtare me vende të ndryshme dhe shqyrton problemet strukturore dhe sistematike të vendeve të ndryshme.



Burimi: Departamenti i Tregtisë

Sa i përket shteteve të CEFTA-së, Serbia është partneri më i rëndësishëm tregtar i Kosovës si në eksport ashtu edhe në import. Eksportet në Serbi në vitin 2017 përbën 13% dhe importi 14.8% të tregtisë së Kosovës. Rritja ishte shumë e fortë si në eksport ashtu edhe në import, me 17% dhe më shumë se 16% respektivisht në vitin paraprak. Rëndësia e Serbisë si një partner tregtar tregon edhe në statistikat specifike të

pengesave tregtare të vendit, sepse në bazë të kompanive që kanë raportuar rreth 50% të të gjitha pengesave për tregtinë aplikohen nga Serbia. Në Serbi, burimi kryesor i problemeve është procedurat doganore, sepse ato janë të paqëndrueshme, të paparashikueshme dhe të ngadalta. Grupi i ardhshëm më i madh i pengesave është barriera teknike për tregtinë. Barrierat teknike të tregtisë ndodhin në formë të

kërkesave të ndryshme të dokumentacionit dhe certifikimit. Në Serbi, hasen probleme në të gjithë sektorët. Ka shume raste kur prodhuesit vendor dëmtohen nga importet bujqësore dhe industriale nga Serbia, kryesisht përmes çmimeve dumping, duke u shitur më lirë se në vendin e origjinës, e cila rrjedhimisht dëmton industrinë e njëjta vendore. Kompanitë janë ankuar sidomos për ndryshimet e vazhdueshme në procedurat doganore dhe për veprimin arbitrar dhe të ngadaltë. Shembuj të problemeve që lidhen me procedurat doganore përfshijnë ndryshime të paparashikueshme në kërkesat e dokumenteve, kërkesa për dokumente shtesë. Çështja e raportit të analizave të kualitetit apo e fushës sanitare dhe fito sanitare mbetet mjaftë shqetësuese. Eksportuesit kosovar obligohen nga autoritetet e Serbisë, respektivisht atyre të ushqimit dhe veterinarisë që të presin me maunat e tyre me ditë të tëra, për faktin se autoritetet serbe nuk i njohin analizat e eksportuesve kosovar. Të gjitha këto, krijojnë kosto shtesë për kompanitë kosovare në kuptimin kohor dhe financiar. Gjithashtu, edhe sa i përket produkteve industriale, ka mjaft raste ku eksportuesit kosovar pothuajse e kanë të pamundur të eksportojnë disa produkte, kjo për faktin se autoritetet relevante të Serbisë nuk i pajisin me leje importuesit e tyre për arsye politike, e cila rrjedhimisht e pamundëson realizimin e eksportit nga kompanitë e Kosovës. Që nga viti 2008, shumë kompani kosovare janë duke u përballur rregullisht me problemin e tranzitit përderisa importojnë nga vendet e BE-së dhe kalojnë nëpër territorin e Serbisë në pika të ndryshme kufitare. Edhe pse kompanitë kosovare posedojnë të gjithë dokumentacionin përkatës, atyre u kërkohet gjithashtu të ofrojnë një licencë të importit që lëshohet

nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë Serbe ose nga Ministria e Bujqësisë. Kompanitë zakonisht detyrohen të kthehen dhe të përdorin një rrugë tjetër përmes Rumanisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë, duke arritur kështu në Kosovë. Për aq kohë sa pritet atje, shpenzimet shtesë shkaktohen në kohë dhe para. Ky lloj problemi mjaft shpesh paraqitet edhe gjatë eksportit. Ndërsa sa i përket Shqipërisë, ka pasur një trend të vazhdueshëm rritës në tregtinë midis këtyre dy shteteve. Në 2017, importet u rritën me 31% dhe eksportet me 43% në krahasim me vitin e mëparshëm. Vlen të theksohet se pak më shumë se 22% e të gjitha barrierave të identifikuarat tregtare janë të lidhura me Shqipërinë. Pengesat në lidhje me Shqipëria sa i përket llojeve të ndryshme të barrierave janë relativisht të barabarta, por shumica e pengesave të raportuara lidhen me mosnjohjen e analizave gjatë eksportit nga autoritetet e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Shqipërisë. Kjo barrierë kryesisht aplikohet për produktet bujqësore. Çështje të tjera që pengojnë tregtinë në mënyrë të qartë përfshijnë mjedisin e vështirë të biznesit. Gjithashtu, mbeten shqetësuese aplikimet e shpeshta sezonale të çmimeve referente ndaj produkteve bujqësore me origjinë kosovare. Nga ana tjetër më pak se 6% e të gjitha pengesave në tregti hasen në Maqedoni; kjo shifër është qartësisht e vogël në raport me pjesëmarrjen e Maqedonisë në tregtinë tonë të jashtme. Sfidat më të mëdha të kompanive vazhdojnë të lindin nga rregulloret teknike dhe standardet që ndryshojnë nga ato evropiane. Problemet e raportuara kanë të bëjnë me eksportin e prodhimeve të mishit në Maqedoni për shkak të mos-dërgimit të inspektorëve maqedonas në Kosovë për verifikimin e operatorëve të interesuar për eksport. Testet dhe certifikatat e kërkuara


për këto produkte janë shpesh të gjata dhe komplekse. Sa i përket problemeve tregtare të hasura në Malin e Zi përbëjnë rreth 6% të të gjitha barrierave tregtare. Barrierat e raportuara bien në disa kategori, më e rëndësishmja është pengesa teknike për tregtinë. Problemet janë më të shpeshtat në sektorin e pijeve. Dhe e fundit por jo me pak e rëndësishme barrierat e identifikuar tregtare janë prezent kohë pas kohe edhe me Kroacinë, ish anëtarë i CEFTA-së tanimë anëtarë i BE-së. Në këtë kontekst barriera të tilla me Kroacinë më shumë i referohen

fushës së zbatimit të MSA-së. Kroacia përbënë 17 % të të gjitha barrierave tregtare. Janë raportuar një numër problemesh në lidhje me barrierat tregtare, por ato shpesh janë të natyrës sistemore dhe lidhen me rregulloren e BE-së nr. 206/2010. Kosova nuk është në listën e vendeve të pranueshme. Sipas kësaj rregulloreje, Kosova nuk është një vend i përshtatshëm për eksporte të caktuara kafshësh dhe mish të freskët. Një problem të tillë Kroacia e aplikon edhe gjatë tranzitit nëpër territorin e saj për produktet me origjinë nga Kosova.

Tregu i brendshëm

Në anën tjetër, barriera të ndryshme janë të paraqitura edhe në tregun e brendshëm të Kosovës, ku më të shpeshta janë ato që lidhen me mjedisin e konkurrencës, të

pasuara nga problemet në lidhje me interpretimin e taksave dhe legjislacionit fiskal kombëtar.



Burimi: Departamenti i Tregtisë

Tatimet, legjislacioni fiskal dhe shpenzimet shtesë

Tatimet, legjislacioni fiskal dhe shpenzimet e tjera me një përqindje prej 70% përbën një problem në tregun e brendshëm.

Bizneset e regjistruara në Kosovë mund të aplikojnë për rimbursimin e TVSH-së të përfshirë në çmimin e mallrave dhe shërbimeve të blera në një shtet tjetër. Vendimi për rimbursim duhet të bëhet brenda një muaji nga aplikimi. Megjithatë, kjo nuk është shpesh rasti në praktikë dhe procesi i rimbursimit mund të zgjasë disa muaj ose edhe më gjatë. Më shumë informata rreth rimbursimit të TVSH-së në Kosovë, ju lutem shihni:

http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/10/DoracakuTVSH_ALB.pdf

Mjedisi i konkurrencës

Bazuar në raportet e kompanive, mjedisi i konkurrencës, përbënte 10% të barrierave tregtare. Problemet kryesisht lidhen me tregtinë në fushën e bujqësisë, ku mjedisi i konkurrencës shkaktoi probleme në

Licencimi

Kërkesat e dokumenteve të licencimit dhe të kontrollit i përkasin kësaj kategorie; barrierat e identifikuara në këtë kategori

Zhvillimet në fushën e lehtësimit të tregtisë si mjet për eliminimin e barrierave tregtare

Edhe pse Kosova ende nuk është anëtare e OBT-së, Qeveria e Kosovës është shumë e angazhuar në realizimin e aktiviteteve në lidhje me lehtësimin e tregtisë. Sipas OBT-së lehtësimi i tregtisë nënkupton “thjeshtëzimin, standardizimin dhe harmonizimin e procedurave të tregtisë ndërkombëtare”, ku me procedura tregtare nënkuptohen aktivitetet, praktikat dhe formalitetet që aplikohen në mbledhjen, prezantimin, komunikimin dhe përpunimin e të dhënave, të cilat janë thelbësore për lëvizjen e mallrave në tregtinë ndërkombëtare”. Një gjë e tillë synon të zhvillohet brenda vendeve të CEFTA-së. Në këtë drejtim, Protokollin 5 për lehtësimin i tregtisë në kuadër të CEFTA-së ka përfunduar. Bazë e këtij Protokollin është Marrëveshja e Lehtësimit të Tregtisë, e iniciuar nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT). Edhe pse Kosova dhe disa vende të CEFTA-së nuk janë anëtare të OBT-së, kanë marrë përgjegjësinë për të zbatuar masat kryesore të kësaj marrëveshjeje, pasi që ato do të jenë pjesë e Protokollit 5, në kuadër të CEFTA-së. Për më tepër ky protokoll parasheh thjeshtëzimin e inspektimeve, reduktimin e formaliteteve të importit dhe eksportit, shkëmbimin elektronik të të dhënave, njohjen reciproke të

operacionet e tyre të biznesit. Format më të shpeshta të monopolit u përmendën më së shpeshti si probleme të mjedisit të konkurrencës.

përbëjnë rreth 20% të barrierave të raportuara në tregtinë e brendshme.

testeve laboratorike dhe programit të operatorëve ekonomik të autorizuar dhe zbatimin efektiv të kontrollit të riskut. Gjithashtu, edhe më e rëndësishme është se do të shtrin efektet e tij edhe tek të gjitha agjencitë e tjera që veprojnë në pika kufitare dhe kjo është vlera e shtuar thelbësore e këtij protokollin. Për më tepër disa nga rezultatet kryesore priten të jenë: shkurtimi i kohës së pritjes për mallrat në kufi, zvogëlimin e kostove të transaksioneve tregtare për kompanitë përmes reduktimit të kërkesës për dokumentacion dhe të dhëna, reduktimi i frekuencës në kontrollet fizike (njohja reciproke e programit të AEO) si dhe përmirësimi i dialogut në mes të sektorit publik dhe privat që do të krijojë një mjedis ku të dyja palët mund të punojnë së bashku për të arritur qëllimet e përbashkëta dhe të adresojnë barrierat tregtare. Për më tepër, sa i përket çështjeve që ndërlidhen me lehtësimin e tregtisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në aspektin e politikës tregtare të Kosovës ka themeluar të ashtuquajturin komitetin nacional për lehtësimin e tregtisë (KNLT) që nga viti 2016. Themelimi i këtij komiteti në nivel nacional të cilin tanimë e kanë themeluar të gjitha vendet anëtarë të CEFTA-së, vjen si

kërkesë nga Sekretariati i CEFTA-së, bazuar në marrëveshjen për lehtësimin e tregtisë në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Themelimi dhe funksionalizimi i plotë i komitetit nacional për lehtësira tregtare, do të ketë një rol kyç në zbatimin e protokollit dhe nëse ky protokoll do të zbatohet me sukses nga të gjitha vendet e CEFTA-së atëherë rezultati kyç i tij pritet të jetë zvogëlimi apo eliminimi tërësisht i barrierave jo-tarifore ndërmjet vendeve. Megjithatë, rezultatet mbetet të shihen, kjo për faktin se duke

Konkluzionet

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka shprehur interesin e saj për të vazhduar mbështetjen e sektorit privat në identifikimin dhe heqjen e pengesave që pengojnë eksportet në tregun ndërkombëtar. Analiza argumenton se edhe pse eliminimi i barrierave tregtare është i rëndësishëm, ajo nuk do të ketë ndikimin e dëshiruar nëse nuk është plotësuar me përpjekjet e qeverisë për të rritur larminë dhe sofistikimin e mallrave që prodhon, që përfshin masa të tilla si përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e aftësive të fuqisë punëtore lokale, duke i inkurajuar dhe mundësuar ndërmarrësinë, dhe rritjen e madhësisë së firmave ekzistuese prodhuese në mënyrë që ato mund të plotësojnë kërkesat në tregjet më të mëdha dhe për të prodhuar mallrat e tyre me ekonomitë e shkallës. Dialogu i vazhdueshëm me sektorin privat është jetik për heqjen efektive të barrierave tregtare. Heqja e disa prej pengesave për zgjerimin e tregtisë në CEFTA të identifikuar në të kaluarën do të kërkojnë zbatim efektiv të marrëveshjes tregtare rajonale. Më konkretisht, heqja e barrierave jo-tarifore të tregtisë do të kontribuojë në zgjerimin e tregtisë në

marrë parasysh problemet politike me disa vende të CEFTA-së ka dyshime se disa probleme tregtare që lidhen me çështjet politike nuk do të zgjidhen përmes këtij protokollit, njeri nga to mund të jetë problemi me tranzitin. Dhe krejt në fund, MTI është në dijeni se përveç barrierave për të eksportuar në vendet tjera, bizneset përballen edhe me barrierat tjera të brendshme përfshirë ato jo-tarifore, të cilat vështirësojnë rritjen e mëtutjeshme të konkurrenshëmrisë së kompanive.

CEFTA dhe duhet të jetë në agjendën e shteteve anëtare të CEFTA-së për integrimin rajonal. Bizneset kosovare tanimë do të kenë shumë më të lehtë adresimin e barrierave tregtare gjatë eksportit, importit apo kalimit transit me mallrat e tyre. Kjo është mundësuar nga Departamenti i Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, i cili në bashkëpunim me projektin e BE-së për mbështetjen e mëtutjeshme të Politikave Tregtare ka krijuar ueb-platformën e re e cila do t'i shërbej bizneseve në Kosovë që përmes këtij instrumenti t'i adresojnë për zgjidhje në një afat rekord të gjitha barrierat tregtare që hasin gjatë eksportit, importit apo kalimit transit me mallrat e tyre në shtetet tjera, qoftë nga pika kufitare apo diku tjetër. Kjo ueb-platformë, është funksionale me linkun e saj: <http://raportobarrierat.rks-gov.net/mainlist.php>. Si përfundim barrierat e aplikuara nga vendet e rajonit janë zakonisht të natyrave të ndryshme, duke përfshirë barrierat teknike të tregtisë dhe standardet sanitare dhe fito sanitare. Në të njëjtën kohë, tranzitimi i produkteve të Kosovës (sidomos përmes Serbisë)

ballafaqohet me pengesa administrative të vazhdueshme. Ka mjaft raste kur raporti i analizave të kualitetit apo e fushës sanitare dhe fito sanitare mbetet mjaft shqetësuese. Kjo barrierë kryesisht aplikohet për produkte bujqësore. Dhe krejt në fund përveç këtyre, tregu i Kosovës mjaft shpesh

dëmtohet edhe nga importet e vendeve të CEFTA-së, respektivisht eksporteve në sasi të madhe duke vë në dyshim edhe kualitetin këtu, si dhe produktet e dampuara të cilat shiten me lirë se në vendin e origjinës të cilat rrjedhimisht dëmtojnë prodhimin vendor të Kosovës.

Referencat

Deardorff, A. and R. Stern (1997), "Measurement of Non-Tariff Barriers", OECD Economics Department Working Papers, No. 179, OECD Publishing, Paris.

<http://dx.doi.org/10.1787/568705648470>.

MIE, 2016. *Marrëveshja e Stabilizim Asociimit*. [Online]

Available at: <http://www.mei-ks.net/sq/procesi-i-stabilizim-asociimit-78>

[Accessed Mars 2018].MTI, 2015. *NTB-të në kontekst të CEFTA-së: Rasti i Serbisë kundër Kosovës*. [Online]

Available at: <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/B30D19DE-F849-4DEC-A966-27E24100B8D9.pdf>

CEFTA-Central European Free Trade Agreement." *CEFTA Home.cefta.int/*

WTO-World Trade Organization." *WTO Home.wto.org*

UNCTAD-United Nations Conference on Trade and Development." *UNCTAD Home.unctad.org*

MTI- Ministry of Trade and Industry of Kosovo." *MTI Home.mti.rks-gov.net*

ASK-Kosovo Agency of Statistics." *ASK Home.ask.rks-gov.net*